

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegj i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Shukri Sylejmani dhe Gyltene Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A.V., nga komuna e Prishtinës, të cilin e përfaqëson Xh. B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurve Y. G. dhe A. G., të dytë nga komuna e Prishtinës, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e të paditurve, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 3317/2013 datë 14.9.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 8.3.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurve, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 3317/2013 datë 14.9.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 3317/2013 datë 14.9.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurve dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komonale, Prishtinë, C.nr.2639/2007 datë 19.12.2012, me të cilin pjesërisht është aprovuar kërkesëpadia e paditësit ashtu që janë detyruar të paditurit që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material për shkak të lëndimeve të shkaktuara më datë 26.6.2006, në mënyrë solidare t'ia paguajnë dhe atë: për dhimbje fizike shumë prej 1.500 €, për zvogëlimin e aftësisë së përgjithshme jetësore shumë prej 2.500 €, për frikën e pësuar shumë prej 1.500 €, të gjitha me kamatë prej 3.5% nga data 16.11.2007 e deri në pagesën definitive. Me pjesën II të dispozitivit është refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit mbi shumat e gjykuara dhe atë: për dhimbje fizike mbi shumë 1.500 deri 2.500 €, për zvogëlimin e aftësisë së përgjithshme jetësore mbi shumë 2.500 deri 5.000 €, për

përjetimin e frikës mbi shumën mbi 1.500 € deri 2.500 €. Me pjesën III të dispozitivit janë detyruar të paditurit që paditësit shumat e gjykuara nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 621,36 € t'ia paguajnë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënim të përmbarrimit forcërisht. Gjykata e Apelit të Kosovës aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ndryshuar përkitazi me kamatën ashtu që janë detyruar të paditurit që paditësit t'ia paguajnë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovës sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë më 19.12.2012, e deri në pagesën definitive.

Të paditurit me kohë kanë paraqitur revizion kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishën dhe çështjen t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjykimin e kundërshtuar konform nenit 215 të LPK -ës dhe gjeti se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se më datë 26.6.2006, paditësi ishte duke bërë sigurimin e garave të peshkimit të cilat mbaheshin në liqenin e Badovcit, ndërsa në atë kohë kanë ardhur të paditurit për tu pastruar në liqen dhe pasi që u është tërheqë vërejtja nga paditësi, për mos pengim të garave, të njëjtit e kanë sulmuar duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, të cilat si pasojë tek paditësi kanë shkaktuar dhimbje fizike, frik dhe zvogëlim të aftësisë së përgjithshme jetësore.

Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke konsideruar se lartësia e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jo material, është shpërblim real dhe objektiv, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën sipas ankesës ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë në

mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe pretendimin e të paditurës se këto shuma janë tepër të mëdha i ka vlerësuar si të pabazuara , ashtu që ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e ankimuar sa i përket shumave të gjykuara, ndërsa duke zbatuar nenin 195.1 lidhur me nenin 201 par.1 pika (d) të LPK –ës ka ndryshuar aktgjykimin lidhur me kamatën , më afër përshkruar si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit pjesërisht është e bazuar. Gjykatat e instancës më të ulët në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, kur kanë gjykuar shumat për kompensim të cilat duhet t'i paguajnë të paditurit paditësit, të cilat arsye i mbështetë edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kundërshtuar e shqyrton konform dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK, ndërsa nuk gjeti shkelje të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate mbi gjendjen e tillë faktike drejt janë zbatuar dispozitat e nenit 200 të LMD -ës lidhur me nenin 323 të LPK -ës, përkitazi me caktimin e lartësisë së dëmit jo material, ngase, shumat e gjykuara janë caktuar në bazë të ekspertizës mjekësore nga eksperti Dr. B. K. - neurokirurg dhe Dr. N. M. - psikiatëre, në bazë të intensitetit të dhimbjeve fizike, intensitetit të frikës së pësuar dhe në bazë të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Vërtetimi i shpërblimit (satisfaksioni) për dëmin jomaterial përfaqëson zbatimin e të drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, gjykata sipas nenit 200 të LMD duhet të kujdeset për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilat i shërben ai shpërblim, por edhe për atë që me të mos të favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimit shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditësit, shkallën e intensitetit dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe frikës dhe zvogëlimit të aktivitetit jetësor, sipas gjendjes së vërtetuar me anë të ekspertizës, e duke

pasur parasysh praktikën e gjertanishme të gjykatave në Kosovë, shumat e caktuara të shpërblimit të dëmit paditësit nga ana e gjykatave të instancës më të ulët sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë reale dhe në përputhje me kriteret e parapara sipas kësaj dispozite, për të cilën arsye gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar të drejtën materiale.

Pretendimin e cekur në revizion se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse të paditurit nuk janë ftuar në shqyrtimin kryesor dhe në këtë mënyrë u është mohuar e drejta për pjesëmarrje në gjykim , Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se pretendimi i cekur ka qenë objekt shqyrtimi edhe para gjykatës së shkallës së dytë e cila në aktgjykimin e sajë ka dhënë arsye të mjaftueshme , të cilat i mbështet edhe kjo gjykatë e revizionit , pa pasur nevojë që të njëjtat të përsëriten edhe njëherë.

Nga sa u tha më lart, e në pajtim me nenin 222 të LPK -ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 8.3.2017, Rev.nr.448/2016

Kryetarja e kolegjit,

Emine Kaçiku